Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut

Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

MENDIM

Data e miratimit: 13 janar 2013

Lënda nr.: 194/09

Petra KOSTIQ

kundër

UNMIK-ut

Paneli këshillëdhënës për të drejta të njeriut, në seancën e mbajtur më 13 janar 2013, në praninë e anëtarëve vijues:

z. Marek NOWICKI, kryesues
znj. Christine CHINKIN
znj. Françoise TULKENS

Të ndihmuar nga:
z. Andrey ANTONOV, zyrtar ekzekutiv

Pas konsiderimit të ankesës së lartpërmendur, të parashtruar në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 për themelimin e Panelit këshillëdhënës për të drejta të njeriut, të datës 23 mars 2006,

Pas shqyrtimit, jep konstatimet dhe rekomandimet si në vijim:

I. PROCEDURA PARA PANELIT

1. Ankesa është parashtruar më 30 prill 2009 dhe është regjistruar në të njëjtën datë.

2. Më 23 dhjetor 2009, 22 qershor 2011 dhe 29 mars 2012, Paneli kërkoi nga ankuesja që të parashtrojë informata dhe dokumente shtesë. Më 6 shtator 2011 janë dhënë disa informata përmes telefonit.

3. Më 24 gusht 2011, Paneli kërkoi informata shtesë nga Zyra Ndërlidhëse për Gjykata (ZNGj) e Ministrisë së Drejtësisë të Kosovës. ZNGj-ja u përgjigj më 2 shtator 2011.

4. Përmes vendimit të 26 shtatorit 2012, Paneli shpalli ankesën si pjesërisht të pranueshme.

5. Më 15 tetor 2012, Paneli ia komunikoi vendimin për pranueshmëri përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), duke e ftuar atë që të jep komentet e UNMIK-ut për bazueshmërinë e lëndës.

6. Më 11 dhjetor 2012, PSSP-ja parashtroi komentet e UNMIK-ut për bazueshmërinë e ankesës.

II. FAKTET

7. Ankuesja është ish-banore e Kosovës, e cila tani jeton në Serbi.

8. Ankuesja deklaron se është pronare e pronës në fshatin Retimlë, të komunës së Rahovecit. Ankuesja ka shfrytëzuar pronën deri në korrik të vitit 1999 kur për shkak të arsyeve të sigurisë dhe pas kidnapimit të djalit të saj, ajo u shpërngul në Serbi. Ajo thotë se prona më pastaj është uzurpuar, dëmtuar, plaçkitur dhe në fund është demoluar nga kryerësit e panjohur.

9. Më 15 qershor 2004, ankuesja parashtroi kërkesëpadi në Gjykatën komunale të Rahovecit kundër Komunës së Rahovecit dhe Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë (IPVQ), përmes së cilës kërkonte kompensim për dëmin e shkaktuar ndaj pronës së saj në shumë prej 280.000 euro.

10. Përafërsisht 17.000 kërkesëpadi për kompensim janë parashtruar para gjykatave të Kosovës në vitin 2004, ku pjesa më e madhe e tyre janë parashtruar nga serbët e Kosovës, të cilët për shkak të armiqësive kishin lëshuar shtëpitë e veta në Kosovë në vitin 1999, dhe prona e të cilëve më vonë është dëmtuar apo shkatërruar. Me qëllim të respektimit të afatit pesëvjeçar të parashkrimit të dorëzimit të padive civile për kompensim, këta kërkesëpaditës i parashtruan kërkesëpaditë e tyre para gjykatave të Kosovës përafërsisht në të njëjtën kohë gjatë vitit 2004. Kërkesëpaditë në përgjithësi parashtroheshin kundër UNMIK-ut, KFOR-it dhe IPVQ-ve, si dhe kundër komunës përkatëse (shih Paneli Këshillëdhënës për të Drejta të Njeriut (më tutje në tekst PKDNj), *Millogoriq dhe të tjerët*, lëndët nr. 38/08, 58/08, 61/08, 63/08 dhe 69/08, Mendimi i 24 marsit 2010, § 1; lidhur me bazën ligjore, mbi të cilën paditësit e bazuan kërkesëpadinë e tyre, shih Mendimin e njëjtë, në § 5).

11. Lidhur me këto lëndë, më 26 gusht 2004, drejtori i Departamentit të Drejtësisë (DD) të UNMIK-ut u dërgoi letër të gjithë kryetarëve të gjykatave komunale dhe të atyre të qarkut, si dhe kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës. Në letër, drejtori i DD-së theksoi se janë parashtruar mbi "14 000 kërkesëpadi" të tilla. Ai iu referua "problemeve që një numër kaq i madh i kërkesëpadive paraqet për gjykatat" dhe kërkoi që "për asnjë lëndë të tillë të mos caktohet seancë gjyqësore, deri kur bashkërisht të vendosim për mënyrën më të mirë të procedimit të këtyre lëndëve" (tekstin e plotë të letrës mund ta shihni në Mendimin për lëndën *Millogoriq dhe të tjerët*, të cituar në § 10 më lartë, në § 6).

12. Më 15 nëntor 2005, DD-ja i ftoi gjykatat që të fillojnë me procedimin e kërkesëpadive për dëme, të shkaktuara nga personat e identifikueshëm fizikë dhe për dëmet e shkaktuara pas tetorit të vitit 2000, duke konsideruar që "pengesat për procedimin efikas të këtyre lëndëve" tani më nuk ekzistonin. Kërkesëpaditë e ndërlidhura me ngjarjet para tetorit 2000 nuk janë trajtuar përmes kësaj letre.

13. Më 28 shtator 2008, drejtori i DD-së njoftoi gjykatat se lëndët, për të cilat nuk janë caktuar seancat në bazë të kërkesës së 26 gushtit 2004, tani do të duhej të futeshin në procedurë.

14. Më 9 dhjetor 2008, përgjegjësia e UNMIK-ut për gjyqësorin e Kosovës përfundoi dhe Misioni për Sundim të Ligjit i Bashkimit Evropian (EULEX) morri kontrollin e plotë operacional në fushën e sundimit të ligjit, pas deklaratës së bërë nga kryetari i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44), përmes së cilës mirëpritet angazhimi i vazhdueshëm i Bashkimit Evropian në Kosovë.

15. Deri më sot, Gjykata komunale në Rahovec nuk ka kontaktuar ankuesin dhe nuk janë caktuar seancat lidhur me padinë e lartpërmendur gjyqësore.

III. ANKESA

16. Për aq sa ankesa është shpallur e pranueshme, ankuesja në thelb pretendon se procedurat lidhur me kërkesëpadinë e saj për dëmet ndaj pronës janë pezulluar, duke ia pamundësuar kështu që të merr vendimin për kërkesëpadinë e saj, që paraqet shkelje të së drejtës së saj për qasje në gjykatë, të paraparë përmes nenit 6 § 1 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (KEDNj). Ajo gjithashtu ankohet që si rrjedhojë e pezullimit, procedurat nuk kanë përfunduar brenda një kohe të arsyeshme, që paraqet shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNj-së. Dhe në fund, ajo pretendon se për të njëjtën arsye e drejta e saj për mjet të efektshëm juridik, e paraparë në nenin 13 të KEDNj-së, po ashtu është shkelur.

IV. LIGJI

Shkelja e pretenduar e nenit 6 § 1 të KEDNj-së

17. Paneli thekson se lënda e ankueses ngritë çështje, thelbin e të cilave ankuesit e tjerë tani më ia kanë parashtruar Panelit. Rrjedhimisht, Paneli përkujton se, për shembull, se në lëndët e bashkuara të *Millogoriq dhe të tjerëve* (të cituar në § 11 më lartë), ka shqyrtuar ankesat e pesë ankuesve, të cilët gjithashtu kanë qenë pronarë të pronave në Kosovë. Në vitin 1999, duke u frikuar nga armiqësitë, ata shkuan nga shtëpitë e tyre në Kosovë. Prona e tyre është dëmtuar ose shkatërruar gjatë pjesës së dytë të vitit 1999 pas hyrjes në Kosovë të UNMIK-ut dhe KFOR-it. Në vitin 2004, këta ankues gjithashtu kanë parashtruar kërkesëpadi para gjykatave kompetente komunale kundër UNMIK-ut, KFOR-it, IPVQ-ve dhe komunave përkatëse, duke kërkuar kompensim për dëmet e shkaktuara ndaj pronave të tyre. As ata nuk janë kontaktuar nga gjykatat dhe nuk është caktuar ndonjë seancë dëgjimore për shkak të ndërhyrjes së lartpërmendur nga DD-ja, përmes së cilës u ndërprenë procedurat gjyqësore nga gushti i vitit 2004 deri në shtator 2008. Për këto raste, Paneli erdhi në përfundim se e drejta e ankuesve që të marrin vendimin gjyqësor për kërkesëpaditë e tyre është shkelur.

18. Në përgjigjen e tij, PSSP-ja jep argumente të hollësishme të bazuara në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut. Në mes të tjerash, PSSP-ja argumenton se kërkesa e UNMIK-ut që procedura të pezullohet duhet të konsiderohet se ka pasur qëllim legjitim dhe se në rrethanat e Kosovës së pasluftës dhe të sistemit të saj juridik në fazat fillestare të zhvillimit, pezullimi i përkohshëm ishte mënyra e vetme për UNMIK-un që të trajtojë këtë situatë të jashtëzakonshme, me të cilën ishte ballafaquar sistemi gjyqësor i Kosovës, të shkaktuar nga numri i madh i kërkesëpadive për kompensim. PSSP-ja

gjithashtu argumenton se ka pasur proporcionalitet të arsyeshëm mes mjeteve të shfrytëzuara dhe qëllimit të kërkuar për shkak se ishte gjetur baraspesha e duhur mes kërkesave të interesit të përgjithshëm për shoqërinë dhe kërkesave për mbrojtjen e të drejtave themelore të individëve. Sipas PSSP-së, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurave duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të caktuara të rastit, ku Gjykata Evropiane zbaton kryesisht tri kritere: sjelljen e autoriteteve gjyqësore, ndërlikueshmërinë e rastit dhe sjelljen e parashtruesit të kërkesës. Vetëm vonesat që i atribuohen shtetit shkaktojnë shkeljen e kushtit për kohë të arsyeshme. PSSP-ja analizon me hollësi zbatimin e tri kritereve të lartshënuara në kontekstin e Kosovës dhe mënyrën se si ato ndërlidhen me ankuesin.

19. Sa i përket sjelljes së ankueses, PSSP-ja argumenton se ajo nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi se është interesuar lidhur me zhvillimet e fundit për rastin e saj apo se është ankuar se rasti i saj nuk po trajtohej dhe se duhej të çohej përpara qoftë në kuadër të gjykatave vendore në Kosovë, të DD-së apo të ndonjë organi tjetër të UNMIK-ut a të IPVQ-ve, duke përfshirë zyrat ndërlidhëse të gjykatave. Ankuesja nuk i është ankuar as EULEX-it pas ardhjes së tij në Kosovë në dhjetor të vitit 2008.

20. Paneli përkujton se tani më ka marrë parasysh dhe ka refuzuar të gjitha këto argumente gjatë shqyrtimit të rastit *Millogoriq dhe të tjerët* (të cituar në § 11 më lartë), të rastit *Berisha dhe të tjerët* (PKDNj, lëndët nr. 27/08 dhe të tjerët, mendimi i datës 23 shkurt 2011, § 24), *Llalliq dhe të tjerët* (PKDNj, lëndët nr. 30/08 dhe të tjerët, mendimi i datës 13 maj 2011, § 21), *Felegi dhe të tjerët* (PKDNj, lëndët nr. 32/08 dhe të tjerët, mendimi i datës 17 gusht 2012) dhe *Stanishiq* (PKDNj, lënda nr. 34/08, mendimi i datës 22 gusht 2012). Lidhur me argumentin se rrethanat në Kosovë duhet të merren parasysh, Paneli konstatoi se është e vërtetë se karakteri i përkohshëm i UNMIK-ut dhe vështirësitë e ndërlidhura duhet të merren parasysh lidhur me një numër situatash, por në asnjë rrethanë këto elemente nuk mund të konsiderohen si arsyetim për zvogëlimin e standardeve të respektimit të të drejtave të njeriut, të cilat kanë qenë të përfshira në mandatin e UNMIK-ut (*Millogoriq dhe të tjerët,* § 44; *Berisha dhe të tjerët,* § 25; *Llalliq dhe të tjerët,* § 22; *Felegi dhe të tjerët,* § 24).

21. Paneli nuk sheh ndonjë arsye për të ndryshuar këto konstatime.

22. Paneli tani dëshiron të shtjellojë argumentin e paraqitur nga PSSP-ja lidhur me ndërlikueshmërinë e kësaj çështjeje. Në komentet e tij për bazueshmërinë, PSSP-ja i referohet lëndës *Stanishiq* të PKDNj-së. Në veçanti, ai thekson referencën e Panelit në faktin se ato kërkesëpadi të parashtruara në gjykatat komunale kanë paraqitur ndërlikueshmëri të caktuara juridike përkitazi me çështjet, siç është imuniteti, të cilat kanë ndikuar në vonesat e procedurave (*Stanishiq,* cituar në § 20 më lartë). PSSP-ja i referohet GjEDNj, më konkretisht rastit *Süßmann kundër Gjermanisë* (nr. 20024/92, aktgjykimi i datës 16 shtator 1996). Ai argumenton se me rastin e marrjes parasysh se a ka pasur vonesë të paarsyeshme të procedurave apo jo, gjithashtu duhet të merret parasysh fakti se vendimet për rastet e tilla, ku ndikimi ka implikime përtej çështjes aktuale në shqyrtim, kërkojnë më shumë kohë para se të merret vendimi i formës së prerë. Si rrjedhojë, kërkesëpadia, ashtu siç është parashtruar nga ankuesi ka kërkuar kohë shtesë para se të merrej vendimi.

23. Paneli megjithatë bën dallim mes argumentit të ngritur nga PSSP-ja lidhur me ndërlikueshmërinë dhe me ankesën e ankuesit. Arsyeja e dhënë nga DD-ja për moratorium nuk ka pasur të bëjë me ndërlikueshmërinë juridike të rasteve, por me numrin e madh të ankesave të parashtruara në gjykatat komunale (shih letrën e DD-së, të

cituar në § 11 më lartë). Ishte vonesa dhe jo ndonjë ndërlikueshmëri tjetër e dukshme e rastit që ka rezultuar me shkeljen e mundshme të obligimeve të UNMIK-ut, të parapara në nenin 6.

24. Ky dallim më tej theksohet edhe në lëndën *Stanishiq*. Për këtë çështje, rasti tanimë është dëgjuar dhe argumentet janë paraqitur. Lidhur me ankesën në fjalë, një aktivitet i tillë procedural nuk është regjistruar, dhe lënda thjeshtë është ngrirë në pritje të vendimit tjetër të DD-së në vitin 2008. Është ky moratorium dhe jo ndonjë ndërlikueshmëri tjetër e dukshme në këtë lëndë, në të cilën është fokusuar Paneli me rastin e shqyrtimit të çështjes së vonesës. Si rrjedhojë, rasti i GjEDNj-së *Süßmann kundër Gjermanisë* (i cituar më lartë) në asnjë mënyrë nuk pasqyron arsye të justifikuar për vonesë me rastin e shqyrtimit të lëndës së ankueses.

25. Lidhur me argumentin e PSSP-së se ankuesja nuk është interesuar për rastin e saj në Gjykatën komunale të Rahovecit, qoftë para ardhjes së EULEX-it në shtator 2008 apo më vonë, Paneli tanimë ka refuzuar këto argumente në lëndën *Llalliq dhe të tjerët* (të cituar më lartë në § 20). Paneli ka konstatuar se ankuesit nuk kanë mundur të fajësohen se nuk janë interesuar tek gjykatat relevante lidhur me gjendjen e lëndëve të tyre (*Llalliq dhe të tjerët*, § 25). Për më tepër, sa i përket argumentit se ankuesja nuk janë interesuar te EULEX-i për lëndët e saj, Paneli ka konstatuar se kjo çështje nuk është relevante për shqyrtimin e ankesës, pasi që situata pas dhjetorit 2008 mbetet jashtë përgjegjësisë së UNMIK-ut (shih § 15 më lartë; *Llalliq dhe të tjerët*, § 26).

26. Paneli nuk sheh ndonjë arsye për të ndryshuar këto konstatime.

27. Në dritën e asaj që u cek më lartë, Paneli konstaton se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNj-së lidhur me pamundësinë e ankueses që të merr vendimin nga gjykatat për kërkesëpadinë e saj, dhe se nuk ka nevojë të shqyrtohet çështja e kohëzgjatjes së procedurave.

Shkelja e pretenduar e nenit 13 të KEDNj-së

28. Paneli konstaton se ankesa në bazë të nenit 13 të KEDNj-së (e drejta për mjet të efektshëm juridik) në thelb ka të bëjë me të njëjtat çështje të trajtuara në kuadër të nenit 6 § 1. Brenda këtyre rrethanave, konstaton se nuk ngritën çështje të veçanta brenda nenit 13 të KEDNj-së (PKDNj, *Millogoriq dhe të tjerët*, cituar në § 11 më lartë, në § 49).

V. REKOMANDIMET

29. Në dritën e konstatimeve të Panelit për këtë lëndë, Paneli është i mendimit se është i nevojshëm një lloj i reparacionit.

30. Do të ishte normale që UNMIK-u të ndërmerr masat e duhura për të ndërprerë shkeljen e evidentuar dhe sa më shumë që të jetë e mundur të trajtojë efektet e saj. Megjithatë. Siç ka cekur më lartë Paneli, (shih § 15) përgjegjësia e UNMIK-ut lidhur me gjyqësorin në Kosovë ka përfunduar më 9 dhjetor 2008, me ç'rast EULEX-i ka marrë kontroll të plotë operacional në fushën e sundimit të ligjit. Rrjedhimisht, UNMIK-u nuk është në pozitë të ndërmerr masa që do të kishin ndikim të drejtpërdrejtë në procedurat para gjykatave komunale.

31. Paneli konsideron se kjo gjendje faktike nuk e liron UNMIK-un nga obligimi i tij për të trajtuar sa më shumë që të jetë e mundur efektet e shkeljeve, për të cilat është përgjegjës. Në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut për gjendjet e juridiksionit të zvogëluar shtetëror, Paneli është i mendimit se UNMIK-u duhet të përpiqet me të gjitha mjetet diplomatike në dispozicion në raport me autoritetet e Kosovës, të merr garanci që lëndët e parashtruara nga ankuesja do të përpunohen në mënyrë të duhur (shih PKDNj, *Millogoriq dhe të tjerët* § 49 dhe *Llalliq dhe të tjerët* § 32, cituar më lartë; krahaso Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut (GjEDNj) (Dhoma e lartë), *Ilaşcu dhe të tjerët kundër Moldavisë dhe Rusisë*, nr. 48787/99, aktgjykimi i datës 8 korrik 2004, *GjEDNj*, 2004-VII, § 333; GjEDNj, *Al-Saadoon dhe Mufdhi kundër Mbretërisë së Bashkuar* nr. 61498/08, aktgjykimi i datës 2 mars 2010, § 171).

32. Paneli më tej konsideron se UNMIK-u duhet të merr hapa të duhur drejt kompensimit të adekuat të ankueses për dëmet jomonetare të përjetuara si rrjedhojë e pezullimit të zgjatur të procedurave të nisura nga jo.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli, njëzëri,

1. KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTA TË NJERIUT LIDHUR ME PAMUNDËSINË E ANKUESES QË TË MERR VENDIMIN E GJYKATAVE PËR KËRKESËPADINË E SAJ;

2. KONSTATON SE NUK KA NEVOJË TË SHQYRTOHET ANKESA SIPAS NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTA TË NJERIUT LIDHUR ME KOHËZGJATJEN E PROCEDURAVE;

3. KONSTATON SE NUK KA NEVOJË TË SHQYRTON ANKESËN SIPAS NENIT 13 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTA TË NJERIUT;

4. REKOMANDON QË UNMIK-U:

a. TË NXISË AUTORITETET KOMPETENTE NË KOSOVË QË TË NDËRMARRIN TË GJITHË HAPAT E MUNDSHËM PËR TË SIGURUAR QË TË NXIRRET VENDIMI PËR LËNDËN E ANKUESES PA NDONJË VONESË TJETËR;

b. TË NDËRMERR HAPAT E DUHUR PËR KOMPENSIMIN ADEKUAT TË ANKUESES PËR DËMET JOMONETARE;

c. TË NDËRMERR MASA TË MENJËHERSHME DHE TË EFEKTSHME PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË PANELIT DHE TË NJOFTOJË ANKUESEN DHE PANELIN LIDHUR ME ZHVILLIMET E TJERA PËR KËTË RAST.

Andrey ANTONOV
Zyrtar ekzekutiv

Marek NOWICKI
Kryesues